

Jashar Kastrati
DREJTOR EKZEKUTIV

Shkollimi:

2002 diplomoi në Fakultetin Ekonomik, në Universitetin e Prishtinës

2010 përfundoi studimet postdiplomike, drejtimi i Menaxhmentit, në Universitetin e Prishtinës

Ka të kryera kurse të ndryshme dhe ka vijuar trajnime nga lëmi i financave, administratës dhe të sektorit të banimit.

Përvoja:

1992-1995 ka drejtuar biznesin privat në Ndërmarrjen për Shërbime Turistike “Teuta Tours” në Gjilan.

2002-2009 ka drejtuar sektorin e Banimit Social në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë. Prej muajit shtator 2009 është në pozitën e Drejtorit Ekzekutiv të Institucionit të Avokatit të Popullit.

- Drejtori Ekzekutiv është zyrtari kryesor administrativ në IAP i cili vepron në varësi të drejtpërdrejtë nga Avokati i Popullit dhe i përgjigjet atij për veprimtarinë e strukturave të institucionit.
- Drejtori Ekzekutiv kryen detyra për bashkërendimin e strukturave të institucionit dhe për zbatimin e politikave të miratuara në fushën e veprimtarisë së tij. Në përputhje me kërkesat e parashikuara me ligj dhe aktet tjera nënligjore si dhe me urdhrat apo detyrat e marra nga Avokati i Popullit, Drejtori Ekzekutiv siguron menaxhimin racional të burimeve njerëzore, të mjeteve financiare dhe burimeve materiale të institucionit.